



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës
Mbledhja nr. 93
Prishtinë, më 22.11.2013, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE
MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS**

Në mbledhje morën pjesë: Ahmet Isufi, Rexhep Selimi, Goran Marinković, Fatmir Xhelili, Ganimete Musliu, Anton Quni, Vjollca Krasniqi, Rasim Demiri dhe Danush Ademi.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Visar Rushiti-GAP, Dhurata Kryeziu-OSCE, Skender Perteshi-QKSS, Luanda Domi-DCAF

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Nur Çeku, Haxhi Xhemalji, Zarife Aliu dhe Antingona Ibraj

Mbledhjen e kryesoi: Ahmet Isufi, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 08.11.2013;
3. Shqyrtimi i situatës së sigurisë në Republikën e Kosovës gjatë zgjedhjeve lokale 2013;
4. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 04/L-230 për Agjencinë e Menaxhimit Emergjent;
5. Të ndryshme;

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës.

Kryetari i Komisionit- Konstatoi miratimin e rendit të ditës.

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 08.11.2013.

Kryetari i Komisionit – Konstatoi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së mbajtur, më 08.11.2013.

Procesverbali u miratuan pa ndryshime.

3. Shqyrtimi i situatës së sigurisë në Republikën e Kosovës gjatë zgjedhjeve lokale 2013.

Kryetari i Komisionit- Sipas marrëveshjes në Komision kemi dërguar kërkesën drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe EULEX-it, të ofrojnë informatë lidhur me ngjarjet e 3 nëntorit 2013, gjatë mbajtjes së zgjedhjeve lokale, sidomos për incidentet e ndodhura në veri të Kosovës, ku ka pasur demolim në tre vendvotime në Mitrovicën e Veriut dhe tendenca për destabilizimin e situatës në veri të Kosovës.

Nga Policia e Kosovës përmes Ministrisë së Punëve të Brendshme, është pranuar informata sot. Sipas kërkesës së Komisionit kjo informatë është kërkuar që të sillet para datës 17 nëntor, pasi janë kërkuar edhe masat të cilat duhet të ndërmerren me 17 nëntor, për të mos u përsëritur aktet që kanë ndodhur në pjesën veriore.

Në bazë të informatës që kemi, konsiderojmë se i gjithë planifikimi dhe implementimi i procesit është udhëhequr nga KQZ-ja në bashkëpunim me Policinë e Kosovës dhe OSCE-në në pjesën veriore.

Sipas Policisë së Kosovës vlerësimi i përgjithshëm i situatës së sigurisë në nivel vendi ka qenë *MESATAR*, gjë që konsiderojmë se është dashur të jetë i shkallës së lartë, pasi është dashur të merren masat në mënyrë që askush të mos lejohet që të prish rendin dhe qetësinë publike, duke bërë veprime antiligjore në pjesën veriore të Kosovës, pasi ka pasur paralajmërime të mëhershme të atyre që nuk kanë dashur që të mbahen votime në veri të Kosovës.

Gjithashtu nxitja nga personalitete të shtetit serb, të cilët kanë hyrë në territorin e Kosovës dhe kanë vepruar në kundërshtim me ligjin dhe Kushtetutën e Kosovës, duke favorizuar vetëm një parti politike, duke bërë edhe një diskriminim edhe për popullatën serbe në veriun e Kosovës dhe në pjesë të tjera, gjë që ka cënuar demokracinë në Kosovë.

Organet e sigurisë në Kosovë, është dashur të ndërmarrin të gjitha masat që të krijojnë ambient të qetë, në mënyrë që qytetarët e Kosovës të votojnë lirshëm dhe jo të shantazhohen, ashtu sic ka ndodhur në mëngjesin e 3 nëntorit, ku grupe të caktuara prej 15-30 personave kanë qenë afër qendrave të vendvotimit dhe kanë shantazhuar qytetarët që të votojnë lirshëm.

Nga informacionet paraprake që kanë qenë të njohura për Policinë e Kosovës dhe EULEX-in, mund të themi se Policia e Kosovës dhe EULEX-i, kanë dështuar në parandalimin e veprimeve të organizuara të grupeve kriminale në veri.

Ende nuk kemi ndonjë informacion lidhur me të dyshuarit dhe pjesëmarrjen në incidentet në veri gjatë zgjedhjeve të 3 nëntorit, në tre qendra të vendvotimeve, nuk kemi informacion lidhur me masat e ndërmarra tutje, se cilat kanë qenë veprimet e organeve të cilat është dashtë të bëjnë ndjekjen e të gjithë atyre që kanë penguar procesin zgjedhor.

Duke llogaritur këtë gjendje të krijuar, nga Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, është kërkuar që të ndërmerren të gjitha masat e sigurisë në mënyrë që në përsëritjen e votimeve në 17 nëntor, të kemi një angazhim me potencial të shtuar, duke vlerësuar si nivel të lartë të rrezikshmërisë, duke pasur parasysh ngjarjet e 3 nëntorit.

Këto masa janë ndërmarrë sipas informatës që kemi dhe është vlerësuar si rrezikshmëri e lartë, mesatare dhe ngjarjet e 17 nëntorit kur janë përsëritur votimet në tre vendvotime kemi një zhvillim normal dhe nuk ka pasur pengesa. Megjithatë grupe të caktuara në vazhdimësi kanë penguar qytetarët që të votojnë.

Konsideroj se edhe me përsëritjet që do të ndodhin në Zveqan në tre vendvotime, nga organet e sigurisë kërkojmë si Komision të ndërmerren të gjitha masat që zgjedhjet e 1 dhjetorit të jenë një proces normal i zhvillimit të zgjedhjeve në pjesën veriore dhe në komunën e Zveqanit.

Thekso se Qeveria e Kosovës, Ministria e Punëve të Brendshme, Policia e Kosovës dhe EULEX-i, gjithashtu segmente të sigurisë duhet të ndërmarrin të gjitha masat që të mos lejojnë hyrjen e personaliteteve nga shteti tjetër të cilët janë me qëllim të caktuar, për të destabilizuar gjendjen në Kosovë dhe për të frikësuar qytetarët dhe përmbysjen e demokracisë në vend, duke përkrahur vetëm një parti politike.

Rexhep Selimi- Për shkak të kohës së shkurtër dhe vonesës në pranimin e informatës nga Policia e Kosovës, nuk mund të bëjmë një analizë të hollësishme të saj.

Mbështes reagimin e Kryetarit që informata nuk ka ardhur në kohë, kur është kërkuar nga Komisioni. Vlerësimi që i është bërë situatës së sigurisë si MESATAR, nuk do duhej të ishte kështu. Kjo informata përmban disa informata të pa nevojshme, kur theksohet se *“Presidentja e Republikës së Kosovës znj. Atifete Jahjaga ka caktuar datën 03 nëntor 2013 ditë të zgjedhjeve komunale në Republikën e Kosovës”*

Nga Komisioni është kërkuar se cilat janë masat policore që kanë të bëjnë me sigurinë që garantojnë një proces të lirë zgjedhor, gjë të cilën u kemi borgj qytetarëve që jetojnë në veri të vendit.

Tri detyrat operacionale që përshkruhen në raport, nuk konsideroj se janë arritur, për shkak se detyra e parë ka qenë ruajtja e rendit dhe sigurisë publike, përcjellja e sigurt dhe sigurimi i materialit (përveç në pjesën veriore) në pjesët e tjera ka shkuar mirë, si dhe ndërmarrja e masave të nevojshme policore ndaj veprimeve të mundshme destruktive dhe kundërligjore ndaj këtij procesi. Masa të tilla nuk janë marrë, sidomos në pjesën veriore, ku ka pasur paralajmërime që

do të ketë tensionim të situatës si dhe protesta të paralajmëruara para fillimi të procesit zgjedhor sic ka ndodhur në Leposaviq.

Me përjashtim të komunave në veri të vendit, në pjesë të tjera siguria ka qenë në nivel dhe zgjedhjet kanë shkuar në mënyrë më të mirë të mundshme, ndërsa në pjesën veriore e cila mbetet më problematikja ka pasur probleme të tilla si dhe pengim, siç ka ndodhur në protestat në Leposaviq para fillimit të procesit zgjedhor, ndërsa Policia e Kosovës nuk ka arritur të përmbush urdhrin operacional për të ndërmarr masa ndaj këtyre veprimeve.

Nga kjo çfarë thashë konsideroj se Policia e Kosovës nuk ja ka arritur të ruaj procesin zgjedhor në pjesën veriore dhe të mbroj qytetarët që të votojnë lirshëm sipas vullnetit të tyre, prandaj kërkesa për informacion nuk ka qenë një kërkesë e kot që kjo informatë të arrij në Komision para datës 17 nëntor, por ka qenë kërkesë e arsyeshme që paraprakisht edhe ne si Komision të bëhemi pjesë e institucioneve të sigurisë duke dhënë kontributin për krijimin e një ambienti sa më të qetë për qytetarët në veri.

Pavarësisht nga ajo se çfarë mund të kërkoj Komisioni për Drejtorinë Policisë ose nga Ministria e Punëve të Brendshme, kjo të bëhet para datës 01 dhjetor 2013 kur mbahen zgjedhjet për balotazh për kryetar të komunave.

Goran Marinković- Pajtohem me Kryetarin dhe z. Selimi se vonesa e raportit nga Policia e Kosovës është një shprehje e keqe. Nga ky raport situata e sigurisë është vlerësuar si MESATARE, gjë të cilën nuk e kam të qartë.

Konsideroj se kjo situatë nuk ka qenë e mesme por e ulët dhe nuk e ka përmbushur detyrën dhe atë çfarë kanë pritur qytetarët.

Në rastin e Graçanicës është imponuar vullneti i zgjedhësve dhe policia nuk ka reaguar në mënyrë adekuate. Përveç presioneve nga anë të ndryshme, kanë kërcënuar me telefon, postë elektronike, se nëse nuk fiton Lista Serbe, do të mbeten pa pensione që merren nga Serbia.

Në ditën e zgjedhjeve Policia e Kosovës e cila ka qenë e angazhuar në komunën e Graçanicës është ndikuar nga kjo situatë dhe kanë arrestuar disa persona me pretekstin se kanë blerë vota, ndërsa ata kanë poseduar pak para. Gjithashtu ka pasur me qindra zgjedhës që janë kontrolluar, pastaj përfaqësuesit e Qeverisë Serbe me zë kanë proklamuar se ata që nuk votojnë për Listën Serbia, nuk janë serb, ndërsa ata të cilët kanë qenë kudnër, janë vënë në cak dhe jeta e tyre është në rrezik.

Në njërin anë nuk kemi pas mbrojtje nga institucionet pjesë e të cilave jemi, ndërsa në anën tjetër kemi pasur sulme nga jashtë. Në këtë situatë pyetja është se si të sillemi ne? Të kërkojmë azil? Kush ka ndikuar që Policia e Kosovës të sillet në mënyrë tendencioze? Për këtë çështje duhet të kërkojmë përgjigjeje.

Kemi pasur paraqitje të dëshmitarëve të rrejshëm dhe kur është vërtetuar që nuk janë dëshmitar të vërtetë nuk janë ndërmarrë masa ndaj tyre. Në këtë proces zgjedhor, asnjë automobil me targa të serbisë nuk është kontrolluar, ka qenë automobili me targa nga Kurshumlia i cili i ka paraprirë kolones si fitimtar. A është identifikuar kjo makinë nga Policia e Kosovës? Pse nuk është reaguar kur materiali zgjedhor është vendos në mure të shkollës?

Nuk kemi pasur mbështetje dhe trajtim të njejt.

Për këtë arsye kërkoj hetimin e shërbimit që është ofruar nga Policia e Kosovës në Graçanicë, për shkak të kanosjes që i është bërë zgjedhësve.

Në emrin tim dhe Kryetarit të Komunës së Graçanicës, kërkoj hetimin në këtë pjesë, përderisa në pjesën veriore nuk ka pasur presione të tilla, ndërsa në komunën e Graçanicës ka pasur. Konsideroj se në këtë komunë është punuar në mënyrë tendencioze dhe për këtë arsye kërkojmë që në të ardhmen të mbrohen qytetarët duke mos u ndryshuar vullneti i tyre.

Propozoj që në javën e ardhshme të ftojme Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Kosovës dhe Ministrin e Punëve të Brendshme për këtë çështje dhe jo vetëm të kemi raporte të tilla sipërfaqësore.

Rasim Demiri- Vlerësoj se raporti është i mirë, ajo cka ka ndodhur në veri është pritur në Graçanicë, Dragash dhe Gorë. Atë që theksoi z. Marinkovic, për ndikimin në vullnetin e votuesve, e njëjta gjë ka ndodhur edhe me komunitetin goran, duke u shantazhuar nga shteti serb. Kërcënimi ka qenë se nëse nuk mbështeten do të ndërpriten pensionet nga Serbia. Si koalicioni Vakat kemi kërkuar integritetin në institucionet e Kosovës, por çfarë ka tendencë të ndodhë, këta njerëz që kanë marrë shumë vota që interesohen për krijimin e Asociacionit të Komunave Serbe, duke e përfshi edhe Gorën në këtë Asociacion.

Nuk e di si janë toleruar këta njerëz nga institucionet serbe, pasi është dashur të pengohet arsimimi paralel që zhvillohet në këto fshatra. Vullneti i zgjedhësve në këto pika nuk është ndryshuar vetëm për serbët por edhe për komunitetin goran, prandaj apeloj që Policia e Kosovës është dashur të krijoj kushtet për zhvillimin e zgjedhjeve.

Fatmir Xhelili- Konsideroj se raporti i Policisë së Kosovës ka përshkruar përafërsisht ndodhitë dhe veprimet që kanë ndodhur me 3 nëntor. Vlerësimet parashikuese të situatës për 17 nëntor dhe lëshimet që kanë ndodhur me 3 nëntor, kanë bërë që Policia e Kosovës të merr veprimet adekuate dhe të krijoj një ambient të sigurt në pjesën veriore. Kemi qenë dëshmitar të asaj që zgjedhjet e përsëritura në tre komuna, kanë shkuar mirë dhe pa incidente. Kjo tregon se Policia e Kosovës është një segment i pjekur dhe që ka kapacitetet njerëzore dhe teknike për menagjimin e situatave të komplikuara.

Mosgadishmëria e EULEX-it për të qenë i qëndrueshëm me 3 nëntor, ka bërë që të zhvillohen ato situata në ato qendra të votimit, ku është marrë materiali zgjedhor.

Përgëzoj Policinë e Kosovës për përkushtimin që ka treguar dhe aktivitete e zhvilluara në pjesën veriore, me rastin e përsëritjes së zgjedhjeve.

Duke qenë se është fillimi i integritetit të qytetarëve serb në institucionet e Kosovës dhe është hera e parë që marrin pjesë në zgjedhje të organizuara nga institucionet e Kosovës, kjo është për tu përshëndetur. Përvoja e fituar nga këto zgjedhje do të shërbejë që në balotazh dhe në zgjedhjet e ardhshme, Policia e Kosovës dhe organet e zbatimit të ligjit bashkë me KQZ-në, të organizojnë zgjedhje më cilësore dhe të bazuara në metodat demokratike të mënyrës së votimit.

Më vjen keq për situatën e përshkruar nga z. Marinković, përkrah qëndrimin që këto raste duhet të hetohen, kur është evidentuar se Policia e Kosovës nuk ka reaguar në mënyrë adekuate ndaj ankesave të qytetarëve serb në Graçanicë. Pra të bëhet një hetim i detajuar se pse pjesëtarët e PK-së në Graçanicë nuk kanë reaguar në mënyrë adekuate.

Policia e Kosovës ka tentuar që të mos influencoj dhe të dominoj duke mos reflektuar me prezencën dhe dominimin e forcës në qendrat e vendvotimeve, duke qenë me tolerante ndaj disa qytetarëve të cilët kanë thyer rregullat e lobimit të kulturuar. Si anëtar i Komisionit, kërkoj që të mbështesim z. Marinković, që këto ankesa në Graçanicë të hetohen, se pse nuk është reaguar me kohë.

Qytetarët serb të cilët janë përcaktuar më herët të kyçen në institucionet e Kosovës, nuk do ta kenë të lehtë. Përcaktimi i tyre është largpamës se të tjerët, kanë përkrahur idenë dhe kanë drejtuar vetën që të jenë pjesë e institucioneve të Kosovës.

Realizimi i projektit të integritetit të qytetarëve serb në institucionet e Kosovës, do të jetë dëshmia më e mirë e angazhimit të përbashkët të qytetarëve serb dhe qytetarëve shqiptar. Jam optimist se pavarësisht vështirësive të kohëpaskohëshme, integrimi do të shkoj në drejtim të duhur dhe se qytetarët serb do të kuptojnë se angazhimi i përbashkët është qëllimi kryesor i këtij projekti dhe krijimi i një ambienti të sigurt dhe integrimi në BE.

Ndikimet e disa individëve të Qeverisë së Serbisë, nuk na ka pëlqyer ndërsa tolerimi ndaj tyre ka bërë që të dëmtohen parti politike të caktuara.

Nuk jam që të ndalohet ardhja e zyrtarëve serb në Kosovë, pasi është më mirë të komunikohet, por organet i sigurisë së Kosovës duhet të reagojnë në momentin kur tejkalohen parametrat moral dhe ligjor, përmes ndikimit në vullnetin e votuesve .

Goran Marinković- Ndoshta Policia e Kosovës nuk ka dashur të dominoj forcën , por e ka treguar në anë të kundërt dhe nuk ka qenë objektive për të gjitha palët në komunën e Graçanicës.

Ju e theksuat z. Xhelili, që ne jemi vizionar që jemi kyçur në institucionet e Kosovës, por mund ta merrni me mend se si mund ti kishim punët sikur mos të ishim kyçur. Interesi im është që të mbesim këtu dhe kam mbrojtur interesat e komunitetit serb në këtë Komision. Ndikimi nga Serbia e ka qorientuar opinionin, pasi prezenca e z. Vulin ka bërë që të ndikohen nga deklaratimet e tij. Prandaj, për zgjedhjet e balotazhit të 1 dhjetorit kërkoj që në Graçanicë të jetë një polici neutrale dhe të kryej punën në mënyrë objektive.

Anton Quni- Pasi në rend dite është shqyrtimi i situatës së sigurisë në Republikën e Kosovës gjatë zgjedhjeve lokale 2013, konsideroj se kjo pikë është gjithëpërfshirëse dhe konsideroj se Komisioni nuk ka autorizimet dhe ekspertizën për të folur për situatën e sigurisë në Republikën e Kosovës.

Komisioni ka për detyrë mbikëqyrjen e organeve që zbatojnë ligjin në fushën e sigurisë, siç janë Policia e Kosovës dhe FSK-ja. Pasi FSK-ja nuk ka qenë e përfshirë, ne mund të flasim për performancën e policisë në zbatimin e ligjit për zgjedhjet lokale.

Për këtë arsye është kërkuar raporti nga Policia e Kosovës, të cilin e kemi marrë në momentin e fundit dhe për të cilin u tha se është gjithëpërfshirës dhe ka përfshirë vetëm incidente që kanë ndodhur në veri të Kosovës.

Konsideroj se autorizimet tona janë që të merremi jo vetëm me situatën e sigurisë në veri të Kosovës, por në tërë territorin e Kosovës, dhe cili ka qenë roli i Policisë në zbatimin e ligjit në të gjitha vendvotimet në të gjitha komunat, në tërë territorin e Kosovës.

Nga raporti shihet një përmbledhje e shkurtër lidhur me vandalizmin që ka ndodhur në disa vendvotime në veri, sidoqoftë nga kërkesat tona të mëparshme është e natyrshme që të kemi korrespondencë pa ndërprerë me autoritetet e policisë, dhe nuk është e thënë që të informohemi vetëm kur kërkojmë, por në çdo kohë duhet të na informojnë.

Në një situatë të tillë të zhvillimit të zgjedhjeve dalin në pah antagonizmat e ndryshëm me ngjyrimet politike. Në këtë situatë roli i Policisë së Kosovës është i veçantë, pasi ka autorizime ligjore se si duhet të sillet karshi situatave.

Shqetësimi ynë është se a janë ndërmarrë të gjitha masat që pas ndodhjes së incidenteve, rasti të hetohet dhe të paraqitet para organeve të drejtësisë. A janë ndërmarrë të gjitha masat nga Policia e Kosovës që të krijohet një besueshmëri e lartë tek qytetarët se shprehja e lirë e votës do të respektohet.

Përvec rasteve të cekura në raport për veriun, nuk kemi informacion se si trajtohen rastet kur shumicën e përbëjnë shqiptarët dhe ku ka pasur shantazh dhe vjedhje të votave në favor të partive politike të caktuara.

Duke u marrë vetëm me raste që kanë ndodhur në veri, po e zhvendosin vëmendjen në një lokacion të kufizuar, duke mos u marrë me raste që e kanë dëmtuar procesin edhe në pjesë të tjera të Kosovës.

Qytetarët për shkak të hezitimit për të paraqitur rastet në polici, i paraqesin në media në organizata jo qeveritare dhe krijohet opinioni jo në bazë të informatës zyrtare të institucioneve të Kosovës, por në bazë të prezantimeve që janë bërë nga mediat.

Në krahasim me zgjedhjet e kaluara ekziston një kulturë më e lartë e qytetarëve që të shprehin vullnetin e tyre, por ende ka militant të partive politike që ndikojnë në vullnetin e zgjedhësve. Mendoj që këta individ dhe personat mbrapa tyre, duhet të bëhen objekt i hetimeve dhe i ndjekjes nga organet e policisë dhe drejtësisë.

Është një fenomen u çuditshëm që Komandantët e Stacioneve Policore, kryesisht janë në shërbim të Kryetarëve Komunal aktual. Për këtë kam shembuj, argumente dhe fakte kur komandantët e stacioneve policore në nivel të komunave, kanë qenë në shërbim të kryetarëve të komunave dhe kanë kryer shërbime në forma të ndryshme, duke i mbledhur votuesit si të votojnë.

Mendoj se MPB-ja dhe Drejtori i Përgjithshëm i Policisë, duke marrë parasysh se duhet të jenë në shërbim të gjithë qytetarëve të Kosovës, por jo vetëm të një subjekti politik të caktuar dhe duhet ti përmbahen ligjit me të cilin janë të autorizuar.

Kjo duhet të jetë temë e trajtimit nga ana e Komisionit, pasi nuk mund të bëjmë vlerësimin e përgjithshëm të situatës së sigurisë por ky është vlerësimi i Komisionit në bazë të informatave që

na janë ofruar në mënyrë indirekte, nga mediat, OJQ-të dhe nuk e di sa mund të jetë i besueshëm i bazuar vetëm në informatat e policisë të cilat janë sipërfaqësore.

Rexhep Selimi- Në fjalën time të parë iu referova informatës së Policisë së Kosovës dhe isha i kufizuar në analizën e situatës së përgjithshme të sigurisë në Kosovë.

Çështja që ngrii z. Marinkovic është shqetësuese dhe e tillë duhet të jetë për të gjitha institucionet e sigurisë në Kosovë dhe jo vetëm komuniteti serb, pasi komuna e Graçanicës e cila është konsideruar e integruar ka probleme të ndërhyrjes nga Republika e Serbisë dhe nga personalitete që e çenojnë vullnetin e lirë të qytetarëve të Kosovës dhe komunitetit serb për tu integruar.

Kur një situatë e tillë ka ndodhur në Graçanicë, çfarë mund të ketë ndodhur në komunat ku nuk ka kontroll institucional nga Kosova. Konsideroj se Policia e Kosovës në veri nuk është për tu përgëzuar, për shkak të manifestimit të lojalitetit të njësive të ndryshme të Policisë së Kosovës ndaj institucioneve të Republikës së Serbisë në veri.

Policia e Kosovës nuk mund të përgëzohet për shkak të prezencës së Mbrojtjes Civile(Civilna Zaštita) në qytetin e Mitrovicës, pasi Policia e Kosovës në këtë pjesë iu ka nënshtruar presioneve dhe ndërhyrjes në veri.

Ndërhyrja me 3 nëntor në tre qendrate vendvotimit në Mitrovicë, nuk ishte ndërhyrje spontane, por ishte ndërhyrje në rezultatet dhe jo në procesin e votimit. Kur është parë numri i vogël i qytetarëve që dalin në votime dhe është parë mundësia e vogël, për të fituar kandidati i Lisët Serbe, atëherë është ndërhyrë dhe janë dëmtuar këto qendra të votimit, për të shkuar në ri-votim. Sa i përket ardhjes së personaliteteve nga Serbia, do të ishte mirë që vizitat e tyre të kontribuonin në normalizimin eventual të marrëdhënieve Kosovë-Serbi, gjë që duket largë.

Mos respektimi i institucioneve të Kosovës, ardhja e z. Vulin me uniform janë tregues që Serbia nuk është për normalizimin e raporteve mes Kosovës dhe Serbisë, por nuk duhet të krahasohet shkuarja e Ministrave të Republikës së Kosovës, të cilët marrin pjesë në Konferenca në Serbi por qëllimet janë të ndryshme me atë të zyrtarëve serb që vijnë në Kosovë.

Pajtohem me z. Quni që Komisioni nuk duhet të bënte këtë analizë, pasi ka funksion mbikëqyrjen e zbatueshmërisë së ligjit. Konsideroj se situata është shqetësuese, përderisa brenda territorit të Republikës së Kosovës veprojnë institucione të sigurisë të shteteve të tjera në territorin e Kosovës dhe prezenca e autoriteteve serbe me qëllim për të ndërhyrë edhe në sovranitetin dhe ndërtimin e brendshëm të Republikës së Kosovës, duke e keqpërdorur këtë mundësi në dëm të sovranitetit të Kosovës. Pasi kjo situatë është shqetësuese, një takim i Komisionit me Ministrin e MPB-së, Drejtorin e Policisë dhe mekanizmat e sigurisë do të ishte më se normale në këtë situatë.

Ganimete Musliu- - Mendoj që situata e sigurisë në përgjithësi nuk guxon të neglizhohet aq më pak nuk është dashtë të neglizhohet me 3 Nëntor 2013, ditën kur janë mbajtur zgjedhjet komunale në Kosovë.

Nëse e shohim rrjedhen e zgjedhjeve të 17 Nëntorit dhe gadishmerinë e organeve të sigurisë si PK, KFOR, EULEX që mbarvajtja e zgjedhjeve të shkojë si duhet çka edhe konsideroj që ka ndodhur, shtrohet pyetja: pse keto masa nuk u morën edhe me 3 Nëntor?

Ngjarjet që ndodhën në pjesën veriore të Mitrovicës me 3 Nëntor nuk kanë qenë të befasishme dhe të papritura, sepse një gjë e tillë është paralajmëruar në vazhdimsi nga strukturat kriminale që veprojnë atje tash e 13 vite, prandaj konsideroj se organet e sigurisë në Kosovë është dashtë më mirë të merren me preventivat sesa që po merren me pasojat.

Unë poashtu mendoj që përveq anës politike kur kemi të bëjmë me sigurinë në atë pjesë të vendit duhet të kemi parasysh edhe anën humane dhe njerzore sepse qytetarët atje përballen me çdo lloj kërcënimi e shantazhi, prandaj apeloj tek organet e rendit që të jenë me të përgatitur dhe më të vëmendshëm, sidomos kur kemi paralajmërime të tilla nga prishës të rendit të cilët asnjëherë nuk ia kanë dashtë të mirën vendit tonë.

Për fund dua ti përgezohet qytetarët e Mitrovicës të cilët kanë dalë në zgjedhje me 17 Nëntor 2013, për kundër asaj që vullneti i tyre është penguar shpesh herë dhe u është cenuar liria e veprimit dhe e vendosjes nga njerëz të njohur me të kaluar kriminale. Kërkoj që organet e rendit edhe në raundin e balotazhit të jenë të përgatitur dhe të jenë në nivel të detyrës në të gjitha komunat ku do të ketë zgjedhje, tua mundësojnë qytetarve daljen në zgjedhje dhe pa pengesa dhe mos të lejojnë që vëmendja të përqendrohet vetëm në një pjesë të Kosovës dhe keqëpërdoruesit të jenë të lirë për të vepruar në zonat të tjera.

Kryetari i Komisionit- Pas analizimit të kësaj informate, mund të them që edhe pse informata është pranuar me vonesë, nuk patëm mundësi të hyjmë në detaje, por në informatë theksohet procesi i zgjedhjeve në tërë territorin e Republikës së Kosovës dhe ndërmarrja e masave të Policisë së Kosovës në gjithë territorin, citoj raportin: *Operacioni është zhvilluar sipas planifikimeve operationale në tërë territorin e RKS-së, dhe PK ka angazhuar të gjitha kapacitetet me qëllim të mbarëvajtjes së procesit zgjedhor. Në të gjitha regjionet operacioni ka qenë i koordinuar mirë me kohë dhe me pastaj është implementuar me sukses.*

Gjithashtu është bashkëpunuar me prokurorinë në rastet kur ka pasur cënim të vendvotimeve ose tendenca për manipulim, për shkak të incidenteve që kanë ndodhur në veri, jemi fokusuar më shumë në këtë pjesë, dhe kemi kërkuar që para 3 nëntorit të gjitha institucionet e sigurisë të ndërmarrin të gjitha masat në mënyrë që të mos lejohen veprime të tilla, pasi kemi pas shenja të paralajmëruara, dhe informata që personalitete që kanë ardhë nga shteti serb, kanë anuar për një subjekt politik dhe kanë cenuar demokracinë e Kosovës.

Gjithashtu duke ditur se grupe të caktuara kriminale janë duke vepruar dhe kemi kërkuar nga Policia e Kosovës dhe EULEX-i, që të ndërmarrin të gjitha masat që të mos lejojnë veprime që e dëmtojnë procesin, konsiderojmë se me 3 nëntor, Policia e Kosovës dhe EULEX-i e kanë neglizhuar situatën duke e vlerësuar situatën e sigurisë si MESATARE, duke mos e vlerësuar pasi është dashur të jetë i nivelit të lartë, duke mos lejuar të ndodhë ajo cka ka ndodhur në pjesën veriore.

Ndërsa sa i përket pjesës së dytë të votimit të 17 nëntorit, me ndërmarrjen e masave duke larguar grupet e caktuara që kanë qenë prezent në vendvotime, është treguar efikasiteti i policisë.

Në gjithë territorin e Kosovës, kudo që ka pasur veprime kundërligjore, që kanë çenuar procesin zgjedhor, edhe me rastin që theksoi z. Marinković, kërkojmë nga Inspektoriati Policor i Kosovës që të na informojnë për procedurat e ndërmarra ndaj shkeljeve të caktuara dhe që janë lajmëruar në IPK.

Konsideroj se është momenti i fundit kur institucionet e Kosovës, përfundimisht duhet ti ndalojnë të gjithë ata që destabilizojnë Kosovën dhe që ndërhyjnë në procese, nëse është vërtetuar me herët që kanë bërë veprime të tilla.

Mund të konstatojmë që si Komisioni me 1 dhjetor me rastin e balotazhit, në të gjitha komunat e Kosovës edhe në vendet që janë të ndieshme, Policia e Kosovës, EULEX-i të jenë të gatshëm në mënyrë që procesi të shkojë si duhet.

Nëse jeni dakord me këto rekomandime, që mund ti dërgojmë MPB-së, PK-së dhe IPK-së, do ta përmbyllim këtë diskutim për informatën e Policisë së Kosovës. Ndërsa propozoj që pas datës 1 dhjetor të mund të ftohet Ministri i MPB-së dhe Drejtori i Përgjithshëm i Policisë.

Rexhep Selimi- Vlerësoj se Komisioni para datës 1 dhjetor duhet të jetë i informuar dhe të sigurojë për masat e marra nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, në mënyrë që procesi zgjedhor të shkojë si duhet. Gjithashtu ti bëjmë me dije MPB-së, që si Komision duhet të jemi të informuar jo vetëm kur kërkojmë por edhe kur nuk kërkojmë, pasi kjo merr kohë deri sa të vjen informata, në mënyrë që të jemi të informuar për situatën.

Goran Marinković- Insistoj që si Komision duhet të takohemi para datës 1 dhjetor me Ministrin e MBP-së dhe Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë, për të parë se si i kanë paraparë këto situata për ditën e zgjedhjeve me 1 dhjetor. Të bëjmë pyetje në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe për të parë sa janë të gatshëm ti përgjigjen pyetjeve tona.

Anton Quni- Pajtohem me rekomandimet e paraqitura, propozoj edhe një rekomandim që IPK-ja të merret me hetimin e rasteve të implikimit të zyrtarëve policor në favorizimin e ndonjë subjekti politik, apo në sabotimin e ndonjë rasti të paraqitur nga qytetarët, për të parë se si ka ndodhur procesi i votimit në ndonjë komunë.

Fatmir Xhelili- Për kërkesën dhe insistimin e z. Marinković, jam kundër që të mbahet takim me Ministrin e MPB-së dhe Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë, para zgjedhjeve, por si deputet është e drejta e juaj të takoheni me Ministrin e MPB-së dhe Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë për të kërkuar ndrrimin e personave që menaxhojnë ekipin e policisë me rastin e zgjedhjeve.

Konsideroj se edhe në veri të Kosovës por edhe në pjesë të tjera, Policia e Kosovës ka qenë në nivel të detyrës, por ka vend për përmirësime dhe jam që rastet e caktuara të hetohen, ku me ndikimin e zyrtarëve policor, rezultatet e votimit kanë ndryshuar.

Kryetari i Komisionit- Pas kësaj, IPK-së ti kërkohet për të gjitha veprimet të ndërmarra kudo që ka pasur ankesa për shkelje nga ana e policisë, poashtu informatë për veprimet paraprake nga Ministria e Punëve të Brendshme për datën 1 dhjetor, ditën kur zhvillohet balotazhi.

Kërkesa e z. Marinković është e kuptueshme, por kërkesa për ta ftuar në Komision mund të reflektoj si një presion para zgjedhjeve, duke qenë se të gjithë ne i përkasim një subjekti politik të caktuar.

4. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 04/L-230 për Agjencinë e Menaxhimit Emergjent.

Kryetari i Komisionit- Grupi punues është formuar për trajtimin e këtij projektligji, dhe nga grupi punues kërkoj vazhdimin e punës.

5. Të ndryshme.

Nuk pati cështje për diskutim.

Me këtë pikë të rendit të ditës, e konsideroi mbledhjen të mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Ahmet Isufi